

Manual metodologjik



për mësimdhënien e historisë online



Centar za građansko obrazovanje
Centre for Civic Education



The
Federal Government



Manual metodologjik për mësimdhënien e historisë online

Botuesi:

Qendra për Arsimim Qytetar (QAQ)



Centar za građansko obrazovanje
Centre for Civic Education

Redaktore:

Dalliborka Ulareviq

Autorët:

Igor Radulloviq

Milosh Vukanoviq

Dizajni dhe produksioni:

Qendra për Arsimim Qytetar (QAQ)

Përkthimi në gjuhën shqipe:

Monika Mrnjaçeviç

Elizabeta Mrnjaçeviç

Nikolla Gjonoviç

*Publikimi **Manuali metodologjik për mësimdhënien e historisë online** është pjesë e projektit “Mësimdhënia e Historisë gjatë Pandemisë COVID 19 - qasje e barabartë për të gjithë”, të cilin Qendra për Arsimim Qytetar (QAQ) e zbaton me mbështetjen financiare të Qeverisë së RF të Gjermanisë.*

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e QAQ-së dhe në asnjë mënyrë nuk mund të interpretohet si qëndrim zyrtar i Qeverisë së RF të Gjermanisë.

Manual metodologjik

për mësimdhënien e historisë online

Podgoricë, 2021.



Centar za građansko obrazovanje
Centre for Civic Education



The
Federal Government



Përmbajtja

- 5 Hyrje
- 7 Mësimdhënia në kohën e pandemisë COVID-19
- 13 Metodatat e mësimdhënies në mësimin online
- 17 Studimi i temave kontroverse historike në klasë (online)
- 23 Temat kontroverse në klasë (online) në Mal të Zi
- 28 Përfundim

Hyrje

Shpërthimi i pandemisë COVID-19 ka sjellë mbylljen ose zvoglimin e ngarkesës së punës në shkollat malazeze. Si vijën e parë të mbrojtjes, Ministria e Arsimit ka krijuar udhëzimet bazë dhe një platformë online për mësimin në distance në shkollat fillore dhe të mesme. Baza e mësimiit elektronikit ishte e përbërë nga mësimi nëpërmjet videove, të cilat kanë zgjatuar 15 minuta dhe të cilat në fund u renditën në një bazë të dhënash në një platformë krijuar veçmas.

Këto aktivitete dhe përpjekja e madhe e stafit arsimor, siguruan vazhdimësinë e procesit arsimor. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se ky lloj i mësimiit nuk ka sfida të caktuara.

Para se gjithash, udhëzimet e Ministrisë të Arsimit ishin të kufizuara. Ministria e Arsimit në një listë të shkurtër ka japur temat prioritare që do të mbulojnë secila lëndë. Mësimdhënësit nuk fituan as udhëzime mbi metodologjinë mësimore online që do t'i ndihmonte ata të transferojnë njohuritë në mënyrë me efektive, as për metodologjinë të mësimiit në distancë që do i ndihmonte nxënësit të zhvillojnë kompetenca. Gjithashtu mësimdhënësit nuk fituan as udhëzime për metodologjinë e vlerësimit të nxënësve dhe rezultatet e mësimiit duke përdoruar mjete të reja. Aspekti i fundit është veçanërisht problematik, sepse jo të gjithë nxënësit kanë qasje të barabarta në materialin online, ndërsa mësimdhënësit duhen të sigurojnë që ata mos të heqin dorë nga procesi arsimor dhe plani i përcaktuar. Gjithashtu, i gjithë materiali arsimor u regjistrua në kryeqytetin e Podgoricës. Mësimi online në lëndën e historisë i ka dhënë përparësi temave të njohurive të përgjithshme, duke kufizuar përpjekjet e mësimdhënësve për të mësuar tema të ndjeshme dhe kontroverse, si për shembull çështjen e pakicave, ose ato tema që zhvillojnë të menduarit kritik dhe analizën.

Edhe pse kalimi në mësimdhënie të plotë ose të pjesshme ishte pjesë e masave emergjente gjatë pandemisë COVID-19, kjo gjithashtu duhet parë si një mundësi për përfshirje më të madhe të teknologjive të reja në procesin arsimor. Për ta arritur këtë, vetë mësimi duhet të bëhet më gjithëpërfshirës, me më shumë staf

mësimor të trajnuar dhe të fuqizuar për të menduar në atë drejtim dhe për të përshtatur përdorimin e mjeteve online me nevojat e grupit të tyre nxënësor.

Projekti “Mësimdhënia e Historisë gjatë Pandemisë COVID 19 - qasje e barabartë për të gjithë”, i zbatuar nga QAQ me mbështetjen financiare të Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, tenton t’u sigurojë mësimdhënësve malazezë mjete mësimore dhe trajnime online, me qëllim që t’ia mundësojnë atyre që të përmbushin rezultatet e mësimin të përcaktuara në kurrikulën kombëtare por gjithashtu të mundësojnë më shumë zëra dhe përgjigje ndaj nevojave arsimore lokale.

Kjo metodologji është rezultat i përfshirjes së asaj përvoje, por edhe përvojës dhe këshillës së kolegëve që morën pjesë në procesin e zhvillimit të materialit mësimor shtesë në internet dhe seminareve shoqëruar, për të cilët autorët janë jashtëzakonisht mirënjohës.

Me dëshirën e sinqertë për ta kthyer procesin arsimor në kuadrin e rregullt sa më shpejt që është e mundur, ne shpresojmë që materialet dhe metodologjitë mësimore të zhvilluara do të përdoren nga mësimdhënësit e historisë dhe lëndëve shoqërore në punën e ardhshme, por edhe në zhvillimin e mëtejshëm profesional.

Mësimi gjatë pandemisë COVID-19

Roli i mësimdhënësit po ndryshon vazhdimisht, duke iu përshtatur rrethanave të panumërta dhe në periudhën e kaluar ai ka përjetuar një nga transformimet më të mëdha në historinë e tij. Përshtatja me situata të reja kurr nuk është e lehtë, veçanërisht nëse përfshin një ndryshim të plotë në konceptin e mësimdhënies. Prandaj, bazuar në përvojën ekzistuese, supozimet shkencore dhe parimet pedagogjike është e nevojshme të ndërtohet qasja më e mirë e mundshme ndaj procesit mësimor, pavarësisht nga rrethanat në të cilat zhvillohet.

Pandemia COVID-19 ka dëmtuar sistemin arsimor si kurr më parë. Mësimi online dominoi gjatë krizës së pandemisë, duke rezultuar në nevojën që mësimdhënësit ti përshtaten shpejt zgjidhjeve të reja, shpesh të panjohura në mënyrë që të vazhdojnë të ofrojnë mbështetje për nxënësit e tyre. Nga mesi i prillit 2020, 191 shtete kishin mbyllur të gjitha shkollat e tyre fillore dhe të mesme, duke prekur gati 1.6 miliardë fëmijë. Kalimi në mësimin në distancë nuk ishte i njëtrajtshëm. Disa sisteme kanë arritur të trajtojnë mësimdhënësit, të prezantojnë mësimin në distancë dhe të krijojnë shërbime mbështetëse për nxënësit në më pak se një javë kohë. Të tjerët vazhdojnë të luftojnë, të kufizuar nga mungesa e qasjes në teknologji ose ekspertizë.¹

Mësimdhënësit dhe stafi arsimor në tërësi luajtën një rol kyç në përgjigjen ndaj pandemisë COVID-19 dhe iu desh të përballeshin me një numër kërkesash të reja gjatë krizës sociale dhe shëndetësore. Shumica e mësimdhënësve jo vetëm që duhej të planifikoj dhe ti përshtatet proceseve arsimore, duke përfshirë përshtatjen e metodave dhe kurrikulave, hartimin e materialeve, formateve

¹ *The path to the next normal* - McKinsey & Company. (2020). Aksesuar me 16 Prill 2021 në: <https://www.mckinsey.com/~/media/McKinsey/Featured%20Insights/Navigating%20the%20coronavirus%20crisis%20collected%20works/Path-to-the-next-normal-collection.pdf>

dhe platformave, por ata gjithashtu duhej të sakrifikonin, në një farë mënyre, privatësinë e tyre për ta bërë procesin sa më cilësor.²

Edhe pse studiuesit kanë arritur të indetifikojnë karakteristikat kryesore të mësimdhënies efektive në klasë, e njëjta gjë nuk mund të thuhet për identifikim dhe vlerësimin e karakteristikave të mësimdhënësve në orën online. Nocioni i pranisë së mësimdhënësve është mbizoterues dhe luan një rol të rëndësishëm në të kuptuarit të një sistemi arsimor të sukseshëm në një klase virtuale, edhe pse kjo temë pothuajse nuk përfaqësohet në literaturë. Nocioni i pranisë në këto rrethana përcaktohet si “*aftësia e nxënësve për të projektuar veten shoqërisht dhe me ndikim në komunitetin kërkimor.*”³

Që mësimi online të jetë i suksesshëm, rekomandohet që mësimdhënësi të ndjekë shtatë parimet e mëposhtme:⁴

1. të nxitë pjesmarrjen e nxënësve;
2. të nxitë bashkëpunim e nxënësve;
3. të nxitë mësimin;
4. të japë reagime të shpejta;
5. të theksojnë kohën për të përfunduar detyrat;
6. të përcjelle pritshmëri të caktuara; dhe
7. të respektoj talentet e ndryshme dhe mënyrat e ndryshme të mësimin.

Poashtu këtyre shtatë parimeve mund t’u shtohen edhe shtatë tjera:

1. të merret me dallimet individuale;
2. të motivojnë nxënësit;
3. të shmangë mbigarkesë të informacioneve;

2 Education in the time of COVID-19, Report, United Nations, 2020. Aksuesar me 20 Prill 2021 në: https://repositorio.cepal.org/bitstream/handle/11362/45905/1/S2000509_en.pdf

3 Welch, A.; Napoleon, L. *Professional Teaching Dispositions of Online Instructors: Why they Matter*. Procedia Soc. Behav. Sci. 2015, 171, fq. 584–589.

4 Adebo, Philip. (2018). ONLINE TEACHING AND LEARNING. International Journal of Advanced Research in Computer Science and Software Engineering. 8. 73. 10.23956/ijarcsse.v8i2.549.

4. të krijojë një kontekst të jetes reale;
5. të inkurajojnë ndërveprimet shoqërore;
6. të mundësoj aktivitete të pavarura; dhe
7. të inkurajojnë të menduarit tek nxënësit.

Përfshirja e teknologjisë të informacionit dhe komunikimit në mësimnxënie dhe mësimdhënie ka ndodhur në të gjithë sektorët e arsimit. Ka ndryshuar natyra e ligjëratave ballë për ballë dhe është mundësuar një rritje jashtëzakonisht e shpejtë e kurseve të përziera dhe online. Teknologjitë e informacionit dhe komunikimit ofrojnë mundësi të reja, por edhe sfida të reja për mësimdhënësit dhe nxënësit. Ndërsa numri i kurseve online rritet, është thelbësore që ne të kuptojmë rolin dhe praktikën e një mësimdhënësi efektiv në internet. Në fund të fundit, duhet të pyesim veten a ka dëgjuar ndonjëherë ndokush prej nesh për platformat si ZOOM ose Microsoft Teams para kësaj situate. Gjithashtu, një pyetje jo më pak e rëndësishme që lind është se sa prej nesh, pavarësisht nga rrethanat në të cilat do të zhvillohet mësimi, do të vazhdojmë t'i përdorim këto platforma, burime dhe mjete digjitale.

Shumica e mësimdhënësve ka arritur të krijoj rutinë të reja. Të tjerët janë ende duke mësuar se si të përdorin metodat klasike edhe përmes platformave për klasa online, të cilat ndoshta ende mund t'i zotërojnë.

Roli i mësimdhënësit në mësimdhënie online nuk është i kufizuar në prezantimin e njohurive. Mësimi online kërkon më shumë nga mësimdhënësit sesa ligjëratat. Në thelb, ai i lejon mësimdhënësit të përshtatin mundësitë e të mësuarit në një numër alternativash për të përmbushur më së miri nevojat e ndryshme të nxënësve të ndryshëm. Nxënësit gjithashtu duhen të përshtaten situatës së re, sepse prej tyre shumë shpesh pritet të mësojnë sa më shumë pa lidhjen e zakonshme shoqërore, por edhe pa mjedisin e zakonshëm të të mësuarit, me të cilin janë mësuar të mësojnë.

Është e qartë se duhet të bëhet një analizë e nevojave për të përcaktuar a është i nevojshëm trajnimi për të mbushur zbrastinë që ekziston në njohuri dhe aftësi. Nuk është e pranueshme që mësimdhënësve dhe nxënësve t'i lihet entuziazmi i tyre, por ata duhen të pajisen me mbështetjen e duhur dhe të nëvojshme nga ana e insitucionave kompetente.

Edhe pse kalimi në mësimin online ishte i papritur dhe i shpejtë për shkak të COVID-19, ai u zhvillua në mes të një procesi më të gjerë të transformimit të teknologjive të informacionit dhe komunikimit në sistemet arsimore. Digjitalizimi në shkolla është bërë i pranishëm kohët e fundit. Argumenti kryesor ka të bëjë me mbylljen e hendekut në mes të mësimin konvencional dhe zhvillimit të nxënësve në shkollë dhe përvojat dhe aftësitë e nevojshme për të hyrë në ekonominë e informacionit. Prandaj, kurrikula shkollore duhet të ndërthuret gjithnjë e më shumë me ICT-un, dhe nxënësve duhet t'u jepen mundësia për të përdorur mjete teknologjike të avancuara dhe burime digjitale për zgjidhjen krijuese dhe inovative të problemeve.⁵

Pyetja se si të arrihet një transformim i vërtetë i mësimdhënies dhe mësimin prek një nga çështjet më të rëndësishme në debatin mbi përdorimin e teknologjisë në arsim.

Duhet theksuar në mënyrë të qartë se mësimi online ka avantazhet e veta mbi qasjen konvencionale, sepse ia lejon nxënësve të shprehin aftësitë e tyre në fusha të ndryshme, jo vetëm në lëndën specifike që mbulohet. Kjo, në veçanti, mund të zbatohet për një grup lëndësh shoqërore, dhe mbi të gjitha për historinë, sepse me një organizim të mirë të klasave, praktika na tregojnë se nxënësit mund të fitojnë njohuritë e nevojshme në mënyrë interaktive. Duhet theksuar se, përveç qëllimeve dhe rezultateve të mësimdhënies, prej mësimdhënësve kërkohet të mbajnë kontakte me nxënësit e tyre në mënyrë që të shpjegojnë integrimin shoqëror të grupeve të tyre mësimore, që është një sfidë e madhe në këto kushte.

Mësimi në distancë mbart stigmën se është më cilësi më i dobët se sa të mësuarit ballë për ballë, pavarësisht studimeve që shpesh tregojnë të kundërtën. Kalimi i pothuajse të gjitha institucioneve arsimore në të mësuarit në distancë, në një mënyrë, krijon një mendim të përhapur se kjo mënyrë e të mësuarit është një opsion i detyruar dhe jo një mundësi shtesë.

⁵ Johannes König, Daniela J. Jäger-Biela & Nina Glutsch (2020) *Adapting to online teaching during COVID-19 school closure: teacher education and teacher competence effects among early career teachers in Germany*, European Journal of Teacher Education, 43:4, fq. 610, DOI: 10.1080/02619768.2020.1809650

Sipas një studimi të UNICEF-it, i publikuar në shtator 2020, mes prindërve të fëmijëve të moshes shkollore në Mal të Zi mbizotëruan mendimet negative për të mësuarit në distancë. Sipas anketës që është kryer, pothuajse 3/5 e të anketuarve ndajne të njëjtin mendim. Nga ana tjetër, afërsisht dy nga pesë prindër e vlerësojnë pozitivisht këtë model mësimorë. Gjithashtu, duhet theksuar se praktikisht 3/4 e prindërve, të cilët nuk e mbështesin këtë formë të të mësuarit, besojnë se brenda kësaj forme fëmijët humbin motivimin dhe zakonet e punës, dhe deklarojnë, në numër të madh, se fëmija largohet nga bashkëmoshatarët, ndërsa më shumë se gjysma besojnë se cilësia e arsimit është jashtëzakonisht e ulët në krahasim me arsimin tradicional. Ndërsa 2/3 e prindërve shprehin një mendim pozitiv në lidhje me mësimin në distancë dhe besojnë se në një situatë pandemike, është më e sigurt që fëmijët të mësojnë në shtëpi. Pothuajse një e treta e prindërve besojnë se sistemi i mësimin në distancë është i organizuar në mënyrë adekuate dhe që siguron një arsim të mirë. Një anë tjetër pozitive e mësimin në distancë sipas mendimit të tyre, është që familja kalon kohë së bashku, dhe se kanë kontrollë më të mirë mbi fëmijën dhe se mund ti ndihmojnë ato të mësojnë më shumë.⁶

Ata që kanë ndërtuar programe online gjatë viteve do të konfirmojnë se mësimi efektiv në klasën virtuale synon të mbështesë nxënësit jo vetëm në mjetet mësimore, por edhe përmes angazhimit të përbashkët dhe formave të tjera të mbështetjes. Konsideroni se sa infrastrukturë ekziston rreth edukimit ballë për ballë që mbështet suksesin e nxënësve: burimet e bibliotekës, shërbimet e zhvillimit të karrierës, etj. Edukimi ballë për ballë nuk është i suksesshëm vetëm sepse mësimi është i mirë. Ligjëratat janë vetëm një nga aspektet mësimore të një ekosistemi të përgjithshëm të krijuar posaçërisht për të mbështetur nxënësit me burime formale, joformale dhe sociale. Së fundi, edukimi efektiv online kërkon investime në një ekosistem mbështetës të nxënësve, i cili kërkon kohë për tu identifikuar dhe ndërtuar.⁷

Krahasuar me opsionet e tjera, shpërndarja e thjeshtë e përmbajtjes në internet

⁶ Istraživanje s roditeljima o školi tokom pandemije COVID-19, UNICEF Crna Gora, Shtator 2020.

⁷ *The difference between emergency remote teaching and online learning* (2020.). Aksesuar: 21.04. 2021., në <https://er.educause.edu/articles/2020/3/the-difference-between-emergency-remote-teaching-and-online-learning>

mund të jetë e shpejtë dhe e lirë, por edhe joefikase nëse nuk zbatohet siç duhet.

Angazhimi i nxënësve rrit kënaqësinë e tyre, rrit motivimin për të mësuar, zvogëlon ndjenjat e izolimit dhe përmirëson arritjet e tyre në mësimdhënien online. Angazhimi është kyç në procesin e të mësuarit, veçanërisht kur bëhet fjalë për mësimin në distancë. Është e nevojshme të krijohen më shumë mundësi për angazhimin e nxënësve në mjedisin online. Nevoja për angazhim ka rezultuar me zhvillimin e udhëzimeve për hartimin e mësimdhënies efektive në internet.

Mësimi në distancë zgjeron aksesin e nxënësve, duke e bërë më lehtë përgatitjen në fusha të ndryshme. Ky lloj mësimi u ofron nxënësve shumë përfitime të tilla si planifikimin fleksibël, kursimin e kohës së shpenzuar për ndryshimin e vendndodhjes, inkurajimin e ndërveprimit midis nxënësve dhe mësimdhënësve dhe më pak stres.⁸

Përveç kësaj, studimet na tregojnë se me këtë mënyrë të të mësuarit, përmbajtja mbahet mend më mirë, dhe nxënësit përshtaten me këtë mënyrë të të mësuarit shumë lehtë, shpesh dhe më lehtë se mësimdhënësit.

Gjithashtu, është e nevojshme të dihet se për përgatitjen e përmbajtjes cilësore online, mësimdhënësve ju nevojitet më pak kohë dhe përpjekje sesa për përgatitjen e klasave në një klasë klasike, përfshirë burimet, kohën dhe materialet.

Duhet marrë parasysh projektet hulumtuese, të cilat u japin nxënësve mundësinë për të ndjekur interesat e tyre brenda kurrikulës, duke kontribuar kështu në motivimin, angazhimin, dhe përdorimin autentik të teksteve dhe burimeve në internet, dhe angazhimin në komunikim dhe bashkëpunim kuptimplotë me të tjerët, online dhe personalisht. Projektet hulumtuese përfaqësojnë një mundësi të jashtëzakonshme për përvojat ndërdisiplinore dhe për të inkurajuar përdorimin dhe zhvillimin e temave të ndryshme.

8 Caron, R.M. Teaching epidemiology in the digital age: Considerations for academicians and their students. *Ann. Epidemiol.* 2013, 23, 576–579.

Metodat e mësimdhënies në mësimin online

Ashtu si në mësimin tradicional ballë për ballë, çdo program mësimi online përdorë një kombinim të metodave të ndryshme të mësimdhënies⁹, të cilat, në thelb, mund të grupohen në tri kategori kryesore:

- **metoda e prezentimit me gojë** – e cila thekson absorbimin e informacioneve të reja. Kjo metodë përfshin prezantime, raste studimore, shembuj të përpunuar dhe demonstrime;
- **metoda e demonstrimit** – e cila thekson proceset aktive të cilët i përdorin nxënësit për të kryer detyra procedurale dhe të bazuara në parime dhe për të ndërtuar njohuri të reja. Metoda e demonstrimit përdoret për të mësuar procedurat. Së pari demonstron procedurën dhe më pas kërkohet nga nxënësit të praktikojë ndërveprimin me sistemin;
- **metoda e mësuarit bashkëpunues** – e cila thekson dimensionin shoqëror të të mësuarit dhe përfshirjen e nxënësve në shkëmbimin e njohurive dhe kryerjen e detyrave. Ky lloj përfshin diskutime të drejtuara në internet, punë ekipore dhe mësimdhënie nga kolegët.

Ndërveprimi midis nxënësve është jashtëzakonisht i rëndësishëm kur bëhet fjalë për mësimin online dhe çon në angazhim shtesë të nxënësve. Me qëllim të parandalimit të ndjenjës së mërzisë së nxënësve dhe izolimit në mjedisin e të mësuarit online, është e nevojshme për të hartuar aktivitete që nxisin angazhim.

Mësimdhënësit që janë përshtatur me mësimin në distancë pa shumë vështirësi shpesh do të vënë në dukje se problemet që hasin në mësimin tradicional

⁹ FAO. 2021. E-learning methodologies and good practices: A guide for designing and delivering e-learning solutions from the FAO elearning Academy, second edition. Rome. <https://doi.org/10.4060/i2516e>

transmetohen edhe në klasën virtuale. Sidoqoftë, duke pasur parasysh mjedisin e panjohur të të mësuarit dhe barrierat e veçanta me të cilat përballen mësimeve në zhvillimin e mësimeve virtuale, disa sfida pedagogjike bëhen posaçërisht të vështira. Problemet më të mëdha që mund të shfaqen janë strukturimi efektiv i mësimit online dhe inkurajimi i diskutimit në internet.

Materiali i përdorur në mësimit online duhet të përgatitet dhe prezantohet qartë në mënyrë që të jetë efektiv. Nëse kjo nuk bëhet në mënyrë të kënaqshme, nuk do ketë rezultate dhe mësimi në distancë nuk do të ketë efekt. Materiali dhe përmbajtja që marrin nxënësit në platformat online është baza për punën e tyre dhe është burimi kryesor i njohjes dhe njohurive. Prandaj, si teknikat ashtu edhe metodat e punës të përdorura duhet të përdoren për të zhvilluar një përvojë pozitive të të mësuarit.

Nga ana tjetër, një nga mënyrat se si shumë mësime punojnë për të përfshirë nxënësit në mësime dhe për të zhvilluar një ndjenjë të bashkësisë është inkurajimi i diskutimeve mes nxënësve në klasën virtuale. Diskutimet mund të jenë mjet i dobishëm, por ato kërkojnë mendim dhe organizim të kujdeshëm. Ndër gjërat që duhet të keni parasysh kur mundësoni diskutimet në internet është mënyra se si të motivoni nxënësit të marrin pjesë në diskutim, të inkurajoni përgjigje thelbësore dhe relevante; të përcaktoni rolin e instruktorit në udhëzimin, moderimin dhe vlerësimin e cilësisë së pjesëmarrjes së nxënësve. Mënyra e shkëlqyeshme për ta bërë këtë është nëse një nxënës bën një pyetje, t'u jepet mundësia nxënësve të tjerë të përgjigjen. Duke caktuar nxënësit si lehtësues të diskutimit, më shumë nxënës do të përfshihen në diskutim. Ky lloj ndërveprimi do të japë gjithmonë rezultate pozitive. Në fund të fundit, diskutimet në internet janë krijuar gjithashtu për të lehtësuar komunikimin dhe shkëmbimin e njohurive midis nxënësve. Nxënësit mund të komentojnë dhe shkëmbejnë ide rreth aktiviteteve ose të kontribuojnë në mësimin në grup duke ndarë njohuritë e tyre.

Shumica e mësimeve punojnë shumë për t'u përgjigjur në mënyrë kreative dhe për t'i mësuar nxënësit të përgjigjen në të njëjtën mënyrë, edhe nëse jeta e tyre është e ngarkuar me probleme. Metoda e cila funksionon më mirë në një mjedis të largët mvaret nga disiplina dhe teknologjia në dispozicion. Megjithatë, ka disa mënyra të gjëra në të cilat institucionet mund të ndihmojnë.

Shumë institucione kanë qendra që ofrojnë mbështetje për mësime në mesimin e tyre; ato qendra duhet të jenë më aktive dhe të përdorohen në angazhim prokativ e jo të “presin derisa të kërkohet ndihmë”.¹⁰

Në periudhën e mëparshme, është vërejtur se në Mal të Zi ka dallime të mëdha kur bëhet fjalë për pajisjen e shkollave me mjete teknike, aftësitë e mësimeve për të punuar në klasa virtuale, disponueshmërinë e përmbajtjes digjitale dhe të ngjashme.

Sipas të dhënave të disponueshme nga qershori 2021, në shkollat fillore dhe të mesme në Mal të Zi ka 16 nxënës për një kompjuter, dhe pajisjet e disponueshme të IT – së shpesh janë tashmë të vjetruara. Përveç kësaj, 150 departamente rajonale të shkollave në zonat rurale nuk kanë lidhje interneti.¹¹

Përveç këtyre çështjeve teknike, ka një numër nevojash shoqërore, emocionale dhe njerëzore që duhet të adresohen në mënyrë që t'u mundësojnë nxënësve të mësojnë.

Situata me COVID-19 kërkon jo vetëm njohuri dhe aftësi, por edhe vetëbesim për sa i përket suksesit në klasën virtuale. Sa i përket zonës afektive-motivuese, fokusi duhet të jetë në vetë-efikasitetin e mësimeve, si një nga aspektet më të rëndësishëm të kompetencave të tyre.¹²

Ndërsa studiojmë shembuj të planifikimit arsimor në kriza, bëhet e qartë se këto situata kërkojnë zgjidhje kreative të problemeve. Ne duhet të jemi në gjendje të mendojmë jashtë kutisë dhe të krijojmë një shumëllojshmëri të zgjidhjeve të mundshme që të ndihmojnë në plotësimin e nevojave të reja të nxënësve tanë.

10 *The path to the next normal* - McKinsey & Company. (2020). Aksesuar me 16 Prill 2021: <https://www.mckinsey.com/~media/McKinsey/Featured%20Insights/Navigating%20the%20coronavirus%20crisis%20collected%20works/Path-to-the-next-normal-collection.pdf>

11 Kvalitetno digitalno obrazovanje – nacionalni prioritet. Aksesuar 09.08.2021. në: <https://www.unicef.org/montenegro/price/kvalitetno-digitalno-obrazovanje-nacionalni-prioritet>

12 Lauermaun, F., and J. König. 2016. “*Teachers’ Professional Competence and Wellbeing: Understanding the Links between General Pedagogical Knowledge, Self-efficacy, and Burnout.*” *Learning and Instruction* 45: fq. 9–19. doi:10.1016/j.learninstruc.2016.06.006

Në disa raste, kjo madje mund të na ndihmojë të krijojmë disa zgjidhje të reja për problemet e pazgjidhshme deri më tani.

Sigurisht, që nga momenti që mësimdhënësi përcakton rezultatet e të mësuarit që duhet të zotërojnë nxënësit, si dhe metodat dhe teknikat e punës, duhet t'i dedikohemi zhvillimit të burimeve që do të përdoren në mësimdhënien online. Sigurisht, kjo përfshin përmbajtjen, materialin, burimet dhe formatin në të cilin do të paraqitet. Përkundër faktit se mund të tingëllojë e komplikuar, nëse zgjidhet një format cilësor dhe i suksesshëm, ai më vonë mund të unifikohet dhe përdoret në zotërimin e rezultateve të reja të të mësuarit.

Në thelb ekzistojnë dy mundësi kur zhvillohet materiali për online mësim. Nëse përmbajtja e duhur ekziston tashmë, mësimdhënësit duhet të integrojnë përmbajtjen e marrë nga burime të ndryshme dhe ta përshtasin atë me nevojat e tyre. Një opsion tjetër është përgatitja e të gjithë materialit nga fillimi.¹³

Çdo mësimdhës duhet, para se të paraqesë materialin, të vendosë pritshmëri të qarta në lidhje me aktivitetet e nxënësve. Udhëzimet e qarta janë një domosdoshmëri. Nxënësve duhet ti ndihmohet ta kuptojnë se çfarë pritet prej tyre, por gjithashtu të inkurajohen të bëjnë pyetje.

Në varësi të rezultateve të të mësimit që duam të arrijmë, ka metoda të ndryshme që mund të përdoren për të vlerësuar të mësuarit. Para së gjithash, aftësitë njohëse të nxënësve mund të maten më së miri me teste vlerësimi. Mësimi online na lejon të bëjmë teste të tilla, por edhe të marrim reagime përkatëse bazuar në to. Këto teste vlerësimi mund të përbëhen nga grupe pyetjesh ose detyrash, të cilat janë krijuar për të konfirmuar arritjen e një rezultati të veçantë ose zotërimin e një aftësie të veçantë.

13 FAO. 2021. E-learning methodologies and good practices: A guide for designing and delivering e-learning solutions from the FAO elearning Academy, second edition. Rome. <https://doi.org/10.4060/i2516e>

Studimi i temave kontroverse historike në klasë (online)

Retrospektiva e sistemit arsimor tregon se tekstet shkollore janë zhvilluar në arsimin e detyrueshëm, të ofruar nga shteti, si një mekanizëm që formon, por gjithashtu specifikon se çfarë duhet të mësojnë nxënësit dhe në çfarë rendi. Për më tepër, tekstet u japin mësimdhënësve udhëzime se si nxënësit duhet ta mësojnë këtë përmbajtje përmes ushtrimeve dhe prezantimeve. Sidoqoftë, roli i mësimdhënësve ka ndryshuar me kalimin e kohës dhe është zgjeruar, ndër të tjera edhe në vlerësimin e tyre profesional në përcaktimin e mënyrës së përdorimit dhe plotësimin të tekstit me aktivitetete të ndryshme edhe burime të tjera.¹⁴

